

Basri Capriqi

Fakulteti Filologjik

Universiteti i Prishtinës

Armiq dhe njerëz

Abstrakt:

Në pjesën e parë ky punim ndalet në identitetin e përbashkët ballkanik, që i ka rrënjët në unitetin kulturor dhe gjuhësor të mbështetur në kulturën greke. Për këtë arsye punimi ndjek zhvillimin e këtij identiteti në politikën e nacionalizmit të shekullit XIX dhe prezanton qëndrimin se ka ardhur koha që konfliktet të mbeten në të shkuarën e që Ballkani të ketë paqe dhe të lidhet më Bashkimin Evropian. Në pjesën e dytë ky punim ndalet në ndikimin negativ të shkrimtarëve dhe intelektualëve për inkurajimin e konfliktit në Ballkan dhe nxjerr në pah shembullin e disa shkrimtarëve, që me frymën e pajtimit dhe humanizmit janë kundërshtarë të rrymës dominante: *Ardhësit: Këngët e Ali Binakut (Došljaci – pesme Ali Binaka)* të Radovan Zogoviçit (Radovan Zogović), *Fundi i lumtur* i Ali Podrimjes, *Içi Miçi Ahmiçi* i Predrag Lluciçit (Predrag Lucić) dhe *Elita më e keqe se turma (Elita gora od rulje)* e Mirko Kovaçit (Mirko Kovač).

Fjalët kyç:

Ballkani, armiku, identiteti ballkanik, shkrimtarët, konflikt

Një armik i lindur nga egërsia e historisë dhe i konservuar nga shkrimtarët

Rrallë mund të gjendet një rajon si Ballkani, për të cilin janë shkruar aq shumë libra historie, kulture e etnopsikologjie, filozofie e astronomie, retorike e politike, folklori e udhëpërshkrimesh e strategjish ushtarake, vepra letrare si kulme të literaturës së gjithëbotshme e prodhime kinematografike kulminante, ku ka ndodhur ndeshje civilizimesh, ndeshje doktrinash fetare dhe ndërlidhje të pashkëputshme kulturore. Janë botuar mijëra e mijëra libra, që nga fillet e antikitetit e deri në ditët tona. Autorë ballkanas të hershëm e të kohëve tona e kanë bërë Ballkanin shpesh pikë referimi për një literaturë kulminante të gjithë globit, kanë vënë themelet e një civilizimi e të një kulture, e cila konsiderohet si më e avancuara dhe më kulmorja e arritjeve të globit në ditët tona. Një gjuhë e lashtë ballkanike, gjuha e vjetër greke, sipas të gjitha gjasave, u bë gjuhë elite e komunikimit të shkruar të të gjithë popujve ballkanas, një gjuhë ballkani që më vonë u bë gjuhë e përmasave globale të botimit, shpërndarjes, krijimit dhe ndërtimit të një civilizimi, i cili me kohë u bë shtrat i gjithë arritjeve shkencore, artistike, politike të njerëzimit në shekujt që pasuan. Popujt e Ballkanit në antikitet kanë investuar gjithë dijen, gjithë trashëgiminë e shkruar, gjithë kreacionin e tyre brenda kësaj gjuhe duke futur brenda kësaj konvence komunikimi gjithë kontributin e vet dhe duke u bërë kontribues në një trashëgimi të përbashkët, që më vonë do të kapërcejë kufijtë e rajonit dhe do të bëhet trashëgimi e civilizimit të shekujve pasues. Gjuhët e tjera të popujve të Ballkanit në antikitet nuk arritën asnjëherë të kapin këto nivele të greqishtes së vjetër. Ata, sipas të gjitha gjasave pranuan një gjuhë të përbashkët për gjithë rajonin, që të ndërtonin brenda saj një sistem kulminant vlerash, një trashëgimi e identitet të shumëfishtë ballkanik dhe jo identitete përjashtuese të rajonit. Kjo gjuhë më vonë u shndërrua në gjuhë të komunikimit të gjerë, për t'u bërë arenë e publikimit dhe shpërndarjes së shpikjeve, që do të bëhen pikë reference për shekujt pasues. Përmasat e asaj shtrirjeje do t'i mbërrijë më vonë gjuha latine e në kohën tonë gjuha angleze.

Eposi homerik, tragjeditë e autorëve të mdhenj të antikitetit si Eskili, Euripidi e Sofokliu, janë një korpus veprash të trashëgimisë ballkanike, ku mishërohet ky identitet i shumëfishtë ballkanik, një epos i përbashkët, autorësia e të cilit asnjëherë nuk mund t'i përshkruhet vetëm një populli, pavarësisht gjuhës ku u përjetësua. Topose të këtilla stilistike janë konstatuar edhe në krijimtarinë orale të hershme të popujve të Ballkanit, por greqishtja e vjetër kishte kapur që herët përmasat e një ombrelle kulturore të rajonit, ishte pranuar nga të gjithë për ta përjetësuar me mjetet shkrimore të avancuara të kohës gjithë pasurinë shpirtërore dhe gjithë identitetin kulturor ballkanik. Për këtë ishin krenarë të gjithë, se i takonin një rajoni të lavdishëm dhe një shtrati kulturor e identitar të përbashkët, që më vonë do të krijojë djepin e civilizimit europian e të të gjithë njerëzimit.

Pushtimet romake do të ndërrojnë nga themelet marrëdhëniet e popujve të Ballkanit ndërmjet vetes dhe marrëdhëniet e tyre me të tjerët. Luftërat do të sjellin zhvendosje popullsish, ndryshim të rendit shoqëror, një dinamikë tjetër në marrëdhëniet e

popujve dhe shkëmbim kulturash e gërshetim identitetesh. Roma e Dioklecianit bëri ndarjen Lindje – Perëndim dhe me këtë futi Ballkanin në një kryqëzim rrugësh, në një shesh ku përplasen perandoritë, ku përplasen civilizimet, po edhe ku gërshetohen kulturat dhe transformohen identitetet e popujve të Ballkanit. Mesjeta solli në Ballkan ndarjen tjetër ndërmjet ortodoksisë dhe katolicizmit, kurse me pushtimin osman iu shtua edhe një ndarje që u shfaq si ndarje ndërmjet islamit e krishtërimin. Jalta i caktoi një fat të keq Ballkanit të pas Luftës së Dytë Botërore, kur në ndarjen e re, pjesën dërmuese të popujve ballkanikë i prangosi në anën fatale të kampit socialist.

Që nga antikiteti popujt e Ballkanit janë pushtuar dhe më pastaj janë bërë pjesë e perandorive më të mëdha: Romës, Bizantit, Perandorisë Osmane dhe bllokut socialist gjatë luftës së ftohtë. Pushtimi i këtyre popujve ka sjellë pasoja të rënda për fatin e rajonit, zhvendosje marramendëse popullsish, dhunim identitetesh me forcë duke asimiluar, duke ndryshuar me dhunë identitete fetare, gjuhësore, zakonore, si dhe rendin tradicional shumëveçar të jetesës. Pas një rezistence të parë, këta popuj të vegjël përballë fuqive aq të mëdha pushtuese, me kalimin e viteve nisën të përshtaten me regjimin e ri dhe u bënë pjesë e këtyre regjimeve perandorake.

Pushtimet perandorake të Ballkanit sollën tragjedi të mëdha për popujt ballkanikë, që rezultuan me humbje të mëdha njerëzore, me rrënime vlerash tradicionale kulturore, me zhvendosje popujsh e me grabitje territore. Me jetën e gjatë që bënë në Ballkan, me përfshirjen e popujve vendas në jetën politike, qeverisëse, administrative e kulturore, regjimet që vinin, fushin një dinamikë të re në marrëdhëniet e këtyre popujve me pushtuesin, por edhe me popujt e rajonit. Në planin identitar, identitetet vendëse futeshin në një marrëdhënie marrje – dhënieje, që rezultonte me ndërrime të konsiderueshme identitare. Meqë, siç ndodh në histori, regjimet e këtyre perandorive favorizonin popujt të caktuar, rrënimi i tyre sillte edhe armiqtë të tmerrshme mes popujve ballkanikë, të cilët dikur krenoheshin për identitetin e përbashkët shumëplanësh ballkanik. Këto ndërthurje, kanë determinuar që në zanafillë marrëdhëniet e dy popujve nga zemra e Ballkanit, shqiptarëve dhe serbëve. Figura e armikut shpeshherë do marrë tipare perandorake të vëna mbi shpinën e këtyre popujve dhe të injektuara në figurën e tyre armiqësore që do vijë duke u rritur e shumëfishuar gjatë gjithë një shekulli.

Popujt e Ballkanit, pas shumë pushtimesh e çlirimesh, pas shumë ardhjesh e rrënimesh të regjimeve perandorake, që me vete sillnin edhe komplekset e veta identitare e kulturore për t'i injektuar në identitetin kulturor ballkanik, me dhunë apo me strategji asimiluese, ata filluan të mësohen edhe me një jetë tjetër identitare. Qytetet e mëdha ballkanike kishin hyrë në një epokë tjetër të identitetit urban. Në të njëjtën lagje, banorët ballkanas të feve të ndryshme, të etnive të ndryshme, të identiteteve gjuhësore të ndryshme, hasnin në pak metra largësi sinagogën, xhaminë, kishën ortodokse, kishën katolike e teqenë bektashiane. Ky ishte identiteti ballkanik. Dhe ballkanasit e kishin kultivuar këtë diversitet si një identitet të vetin shumëfishor. Udhëpërshkrues të ndryshëm që udhëtonin në hapësirën jetësore ballkanike e që ishin shpeshherë vendimtarë për ndërtimin e perceptimit për identitetin ballkanik, e

theksonin këtë fakt dhe e përcillnin në qendrat europiane si një mrekulli të respektit e të tolerancës, ku identitete të ndryshme mund të jetojnë së bashku duke respektuar dallimet dhe duke e njohur atë diversitet si pasuri të veten të përbashkët. Mbi këtë shtrat kulturor me shumë ura ku kryqëzohen kulturat e civilizimet, kanë arritur kulmet e letërsisë europiane shkrimtarët: Ivo Andriq (Ivo Andrić), Ismail Kadare, Kazantzakis, Ionesko, Pamuk, Krleža, Todorov etj. Ky është identiteti i shumëfishtë ballkanik, shpirti i këtyre popujve, një pjesë e rëndësishme e identitetit europian.

Identiteti i shumëfishtë ballkanik, pasuri dhe mallkim për popujt e Ballkanit

Identiteti i shumëfishtë ballkanik do të mbetet pasuri e tyre civilizuese për një kohë jo shumë të gjatë. Diversiteti kulturor i tyre do të kthehet në një mallkim të tmerrshëm me shpërbërjen e perandorive dhe me shfaqjen e egërsisë së paparë në fillimet e krijimit të shteteve kombëtare. Luftërat Ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore e ktheu Ballkanin në një kasaphanë të paparë. Perceptimi për Ballkanin si një identitet diversiteti kulturor, ku jetojnë pranë e pranë gjuhët, etnitë, fetë e kulturat, nis të përmbysset marramenshëm. Dimitrije Tucoviq (Dimitrije Tucović) raporton nga Kosova për këtë katrahurë më 1913:

“Ajo që Luftërave Ballkanike u vë vulën si luftërat më barbare dhe më gjakpirëse të Mesjetës së errët, nuk janë përrënjtë e gjakut e kufomave të rëna nga të gjitha palët e të njerëzve të armatosur, të cilët kanë dalë në luftë: jo, janë lumenjtë e gjakut të banorëve të vvarë të paarmatosur, fëmijëve të pafajshëm, grave dhe njerëzve paqësorë, botës punëtore të Serbisë së Vjetër, Shqipërisë, Maqedonisë, Trakisë, faji i vetëm i të cilëve është se i luten Zotit në një mënyrë tjetër, sepse flasin një gjuhë tjetër, mbajnë një emër tjetër ...” (Tucović, 1913, 60)

Fuqitë e mëdha të kohës, në përpjekje për të vënë paqen në Ballkan, krijuan fusha të minuara mbi të cilat do ecnin popujt e Ballkanit gjatë gjithë shekullit pasues. Me Kongresin e Berlinit në vitin 1878, Konferencën e Londrës në 1913, Konferencën e Paqes në Paris në 1919 dhe Takimin e Jaltës në 1946 në Ballkan u instalua urrejtja e përhershme nërmjet popujve të Ballkanit. Popujt që krenoheshin me një identitet të përbashkët e të larmishëm kulturor, me një traditë respekti për ata që janë ndryshe, do të vuanin një shekull të egërsisë kombëtare ndaj njëri-tjetrit. Shkrimtari shqiptar Gjergj Fishta, një prift françeskan, thoshte: “Për më shumë se një shekull jetuan në mërinë e njëri tjetrit”. (Todorova, 1997,). Fundi i Luftës së Parë Botërore i vuri Ballkanit damkën fatale – fuçi baruti që mund të shpërthejë në cdo cast. Termat Ballkan dhe ballkanizim shfaqen për herë të parë menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Me 20 dhjetor 1918 botohet në *New York Times* një intervistë me Rutenau. Termi *ballkanizim* që nga ai moment kishte kuptimin e copëzimit të shteteve e të popujve. Kjo damkë do rëndojë mbi ballkanasit gjatë gjithë shekullit XX e do të përmbysë perceptimin pozitiv për identitetin e tij.

Viti 1843 sjell në skenën ballkanike Ministër të Brendshëm të Serbisë Garashaninin (Ilija Garašanin), i cili në vitin 1844 harton “*Načertanien*” (Naçertanije), bazuar në të drejtën historike që rrjedh nga tradita e shtetit mesjetar serb. Sipas saj, pas rënies së Perandorisë Osmane Ballkani duhet t’u takojë ballkansve. Por duket se kjo ishte hipokrizi, pasi qëllimi i këtij dokumenti ishte vendosja e hegjemonisë së brendshme kombëtare (Stranjaković, 1939, 76-102). Ky dokument i paralajmëronte ballkanasit për shekuj urrejtjeje etnike, fetare, gjuhësore e identitare. Nga një identitet i shumëfishtë ballkanik që ata kishin ndërtuar, popujt e Ballkanit po përgatiteshin të futeshin në një arenë konfliktesh me identitete kundërshtuese që s’mund të jetonin pranë njëri-tjetrit.

Vlladan Gjorgjeviq (Vladan Đorđević) në librin e tij *Shqiptarët dhe Fuqitë e Mëdha* i shpall shqiptarët të egër, të padenjë për shtet, njerëz me bisht, e si rrugë për menaxhimin e tyre propozon mbikqyrjen e shqiptarëve nga populli më i ngritur serb:

“Vetëm një shtet i huej do të mundte me vue rend në Shqipni e me u mundue që të formojë një komb prej Shqiptarësh, të cilët sod s’janë tjetër vecse një lamsh fisesh qi as gjuha, as tradita as ndonji e shkueme politike e kulturele nuk i bashkon. Në politikë e sidomos në politikën ndërkombëtare mund të flitet vetëm për popuj e kombe, cka shqiptarët nuk janë edhe. Shqiptarët gjenden edhe në gradën e zhvillimit parahistorik. Ata mund të quhen vetëm një grumbullim syngjenetik. Asht një send thjesht i vrashët me pamë Austrinë e Gjermanin në kujdes për t’i dhan autonomi një populli n’Evropë qi asht edhe kryekëput i egër.” (Vlladan Gjorgjeviq, 2012, 181, 200).

Librin e ish Kryeministrit të Serbisë Vlladan Gjorgjeviq e ka përkthyer nga origjinali në vitin 1928 Mustafa Kruja, intelektual që më vonë do të bëhej Kryeministër i Shqipërisë në qeverinë kuislinge.

Ilija Garashanini e Vlladan Gjorgjeviqi u pasuan nga Vasa Çubriloiviqi (Vasa Čubrilović) i cili hartoi dokumentin tjetër të quajtur *Iseljavanje Arnauta (Shpërngulja e arnautëve)*, shpalosur në Srpski Kulturni Klub (Klubi Kulturor Serb) në Beograd më 7. 03. 1937. Më 30. 01. 1939 Ivo Andriqi (Ivo Andrić) harton dokumentin tjetër të këtij korpusi *Elaborat o Albaniju (Studim mbi Shqipërinë)*, që u bë i njohur për publikun vetëm në vitin 1977 nga Bogdan Krizman në *Časopis za suvremenu povijest* me titull *Elaborat dra Ive Andrića o Albaniji iz 1939 god.* (Bogdan 1977/9).

Shkrimtari shqiptar Esad Mekuli, i njohur për poezitë e tij me frymë humanizmi për vëllazërinë e popujve në Jugosllavi, reagon në stilin e tij me rastin e publikimit të dokumentit sekret më 1977²⁰³:

²⁰³ Dokumenti mund të gjendet në: B. Krizman, *Elaborat dr Ive Andrića o Albaniji iz 1939. godine* (në) *Časopis za suvremenu povijest*, Zagreb 1977.

SI KE MUNDUR?

Duke lexuar tekstin e një dokumenti nga viti 1939,
i cili u publikua tash vonë,
të shkruar nga I. A.

Fjalë pas fjale – faqe të tëra ke shkruar –
faqe dhune, robërie e smire?...
Ëndërrues i dikurshëm, në burgje i sprovuar,
t'i robëros të tjerët? Të ndjellish ditë errësire?!
Si t'i marr sot, në këto ditë lirie,
fjalët e tua farmak?
Po shkrimet tua të tjera, që aq të patën hije?!
Syve si t'u besoj?... Ti, që nderimin e pate hak,
vallë,
lirinë e tjetrit ta vësh në darë e lak?!

Reforma agrare dhe marrëveshjet ndërshtetërore për këmbimin e popullsisë nga rajoni i Ballkanit për në Anadoll janë ndërmarrje që forcuan edhe njëherë rrugën e këtij rajoni drejt një tragjedie ku e pësuan qindra e mijëra njerëz, duke u zhvendosur e duke u vrarë mizorisht me qëllimin absurd të krijimit të territoreve të pastra etnike, gjuhësore, fetare e identitare. Pasuria e diversiteteve kulturore e identitare e Ballkanit u shndërrua në një barrë të rëndë, nga e cila ky rajon nuk mundi të shkarkohej.

Luftërat e fundit në Jugosllavi e sollën Ballkanin edhe një herë në skenën botërore me mizori, vrasje, zhvendosje e qindra mijëra njerëzve, spastrime etnike, kulturore e fetare, dhunime e kampe përqendrimi. Në formën më të egër u sollën edhe një herë në memorien e njerëzimit barbaritë që ky rajon kishte pësuar nga krahurat e kohëve që kujtonim se i kishim lënë pas njëherë e mirë.

Këto luftëra shkatërruese sollën edhe një damkë tjetër për rajonin e që bie mbi elitat akademike e intelektuale. Rrallë mund të gjendet ndonjë konflikt i këtyre përmasave, që të ketë angazhuar kaq shumë shkrimtarë e akademikë në mbështetje direkte të luftës shkatërruese për popujt që kishin jetuar në Jugosllavi për gati një shekull. Një ushtri e tërë shkrimtarësh, historianësh, akademikësh e klerikësh u vunë në krah të gjeneralëve për t'i dhënë fuqi më të madhe urrejtjes, deri në shfarosje të të tjerëve, me të cilët kishin bashkëjetuar. Shkrimtari malazet Jevrem Brković (Jevrem Brković) deklaronte se pas përfundimit të luftërave në Jugosllavi *duhej të krijohet një tribunal i Hagës vetëm për shkrimtarët.*

Pra, perceptimi negativ për Ballkanin ka ardhur duke u rritur që nga fundi i Luftës së Parë Botërore e deri më sot. Ballkani si *fuçi baruti* perceptohet sot si një rajon primitiv përballë pjesës tjetër të Europës, të cilët, me të njëjtin mekanizëm e kanë shpallur veten të qytetëruar. Vetë ballkanasit kanë zgjedhur një rrugë origjinale për t'i ikur kësaj damke, duke mohuar të qenit ballkanas dhe duke nxituar me çdo mjet arratisjen nga ky identitet shumëshekullor.

T'i vësh këtij rajoni një damkë djallëzore, t'i hedhësh një mallkim që para një shekulli dhe të mos ia heqësh më, është një padrejtësi e rëndë. Popujt e Ballkanit kanë pranuar të futen sot brenda një projekti madhor, paqësor e civilizues siç është Bashkimi Europian. Disa kanë arritur të bëhen anëtarë të plotë, disa janë në rrugë të plotësimit të standardeve që kërkohen për anëtarësim. Ky duket të jetë projekti që pajton përfundimisht popujt e Ballkanit, një lëvizje e lirë njerëzish, vlerash e kulturash, një bashkëjetesë identitetesh në një paqe të qëndrueshme. Perceptimi negativ për Ballkanin duhet të mbyllet sepse është mbyllur përfundimisht një epokë konfliktesh. Ballkani, pavarësisht tragjedive që ka përjetuar për një shekull konfliktesh të ashpra, nuk mund të jetë pikë referimi për krimet më të mëdha që ka kaluar njerëzimi, e as që duhet t'i mvishet si e përjetshme damka si pjesë e errët e botës. Perceptimin e dikurshëm pozitiv për Ballkanin duhet të gjejnë forcë ta kthejnë vetë ballkanasit, duke lënë pas shekullin e konflikteve e duke nisur epokën e respektit e të njohjes, të ndarjes me të kaluarën konfliktuale e të bashkimit me projektet e mëdha paqësore e zhvillimore europiane.

Autonomia e gjuhës përballë realitetit të dhunuar

Angazhimi i shkrimtarëve në konflikte përmasash të mëdha është dukuri që ka dominuar literaturën botërore prej sa mbahet mend e deri në ditët tona. Në rastet më fatlume, angazhimi i tyre ka shkuar në drejtim të humanizmit dhe të lirisë universale. Në shumë raste shkrimtarët janë bërë mbështetës të ideologjive gjenocidale apo hartues të tyre. Ka pasur nga ata që kanë madhëruar qëndrimin indiferent përpara tragjedive të mëdha të njerëzimit. Luftërat në Jugosllavi kanë sjellë një rekord: një numër të madh shkrimtarësh përkrahës të luftrave shfarosëse, nxitës të urrejtjes etnike, hartues të projekteve gjenocidale. Shkrimtarët si asnjëherë më parë, janë vënë në shërbim të propagandës nacionaliste me një gjuhë të vrazhdë urrejtjeje.

a. Radovan Zogoviq (Radovan Zogović) - T'i mbrosh të tjerët nga vetja

Në vitin 1937 në Jugosllavine e para Luftës së Dytë Botërore, Radovan Zogoviqi nga Deçani i Kosovës e i ardhur që fëmijë nga Andrijeviça e Malit të Zi, së bashku me familjen e tij koloniste, boton një libër të rrezikshëm për të dhe për kohën, me fuqinë humane që rrezaton, me guximin njerëzor që e karakterizon dhe me gjuhën e papërsëritshme paqësore të strukturuar, në një ambient të dhunës ekstreme e të terrorit shtetëror mbi popullatën civile të një pjese të territorit (Zogovic, 2009). Shkrimtari Zogoviq kishte ardhur në Kosovë që fëmijë, së bashku me familjen e tij, në kuadër të operacioneve famëkeqe të projektit të dhunshëm të kolonizimit të Kosovës me popullsi joshqiptare, me synim ndryshimin e strukturës kombëtare të këtij territori. Ky kolonizim është ndërmarrë nga aparati shtetëror, duke zhvendosur mijëra familje serbe e malazeze nga viset malore dhe duke i vendosur ato dhunshëm në pronat e familjeve shqiptare. Ky kolonizim shënon një nga aksionet më të dhunshme në gjithë Europën Lindore dhe një nga teroret shtetërore më të tmerrshme të ndërmarra në aksionet e ngjashme të dyndjeve masive me forcë të popullsive.

Shkrimtari që kishte parë dhunën me sy ndaj të tjerëve dhe kishte ndjerë dhimbjen njerëzore për familjet shqiptare që përjetonin masat më drastike të terrorit shtetëror, shkrimtari të cilin fati e kish sjellë të ishte edhe vetë kolonist, fat që nuk e kish zgjedhur, por që i kish rënë, vendosi të *mbrojë të tjerët nga vetja* me një fanatizëm luftarak revolucionar, të cilin do ta paguante gjatë gjithë jetës me mohim, persekutim, ndalim dhe me ekskomunikim e mosrehabilitim të përjetshëm. Përfundimisht në vitin 1937, Zogoviqi kishte botuar një libër shumë të rrezikshëm, ndoshta më të rrezikshmin në Ballkan. Për këtë atij nuk ia falën asnjëherë, as regjimi i Jugosllavisë së Vjetër, as regjimi i ri komunist, të cilit ai i përkiste, si aktivist revolucionar i së majtës dhe pjesëtar i literaturës sociale, as strukturat e reja të pushtetit postkomunist deri në ditët e sotme. Rehabilitohen e madhërohen në ditët tona bashkëpunëtorë të fashizmit, shkrimtarë kriminelë që kanë hartuar projekte gjenocidale dhe njerëzit qëndrojnë në radhë për të marrë një firmë prej tyre. Ky mentalitet nuk mund ta rehabilitojë kurrë humanistin Radovan Zogoviq.

Zogoviq me librin e tij të rrezikshëm *Ardhësit – Këngët e Ali Binakut* ka thyer një traditë ballkanase të angazhimit të shkrimtarit në konflikt. Prandaj nuk i falet. Shkrimtarët kishin fituar statusin e lartë shoqëror si *bard i kombit* dhe si *ndërgjegje e kombit* duke mbrojtur lirinë e komunitetit të vet. Bardi, apo si u quajtën më vonë mbrojtësit e fuqishëm, *babai i kombit*, angazhohej për të mbrojtur të vetët nga të tjerët dhe këtu përfundon angazhimi i bardit për lirinë si vlerë universale e njerëzimit. Posa hapet fusha e përgjakshme ku duhet mbrojtur të tjerët nga vetja, bardët e kombit hedhin perden e errët e heshtjes. Ky është hapi që e bën të papërsëritshëm Radovan Zogoviqin, maksima e papërballeshme nga bashkëkohësitt dhe ata që do vijjnë: *të mbrosh të tjerët nga vetja*. Kur të tjerët heshtnin përpara terrorit, apo viheshin në kraht të operacioneve ndëshkuese, Zogoviq e quante aksionin me emrin e vet: *Ai plug që futet në arat tona/ nuk është plug/ është thikë futur mes nesh / në mishin tonë të tokës*. Dhe shfaqte optimizmin e tij për viktimat si dhe vizionin e tij profetik: *Tre mbretër që kanë ardhur/ për të mos shkuar/ kanë shkuar/ janë thyer si poça*.

b. Ali Podrimja- ruajtja e gjuhës përmes ironisë

Në vitet 80-të të shekullit të kaluar, për më shumë se një dekadë, një armatë e fuqishme shkrimtarësh përgatitën terrenin, me një propagandë të pashembullt për gjysmën e dytë të shekullit XX, për luftën e përgjakshme në Jugosllavi, që do të merrte dhjetëra mijëra jetë njerëzish dhe do të zhvendoste qindra mijëra civilë. Një propagandë e këtitillë nga kaq shumë shkrimtarë e akademikë, si thirrje për luftë e për shfarosje të etnive të tëra ishte bërë vetëm në prag të Luftës së Dytë Botërore nga një numër i madh shkencëtarësh që përgatitnin terrenin për shfarosjen e hebrenjve duke e arsyetuar me rrezikun që i kanosej botës prej tyre. Beteja e shkrimtarëve ka nisur më shumë se një dekadë përpara betejës së Armatës Popullore të Jugosllavisë, pikërisht nga Kosova, duke shpallur rrezikun e madh që i kanoset Jugosllavisë nga shqiptarët. Propaganda e shkrimtarëve, akademikëve dhe klerikëve, e shtrirë në gati dy dekada

dhe e përcjellur fuqishëm nga një makineri e centralizuar shtetërore mediale, kap shifrën e 4000 librave e botimeve me tirazh astronomik për kushtet ballkanike, vetëm për Kosovën dhe kundër të drejtave të shqiptarëve.

Në këtë klimë tensioni e urrejtjeje shkrimtari Ali Podrimja në vitin 1988 boton librin poetik me titull *Fund i gëzuar*, ku Podrimja thëllon dukshëm ndërthurjen e ironisë në një përmbysje totale të koncepteve, me një drejtpërdrejtshmëri mahnitëse të artikulimit. (Podrimja, 2013). Shqiptime siç janë: *fajtor është shqiptari, unë jam egërsirë, unë jam qen*, shënojnë nivelin më të lartë të ironisë me ç'gjë autori ka arritur të rrënojë e të përmbysë atavizma të ngarkuara gjatë, me dhunë e destruksion njerëzor. Vetëm me këtë përmbysje, me këtë kthim tejet të drejtpërdrejtë në vetën e parë, autori ka mundur t'i shpëtojë rrezikut permanent që të zhytet në vorbullën e helmimit të gjuhës. Luftimi i dhunës me të njëjtat mjete e me të njëjtën strategji gjuhësore bart rrezikun e degjenerimit në fakturë pllakateske ligjërimore. Ironia është e vetmja armë efikase, e cila, me t'u futur në mes, të largon nga ai rrezik dhe ta bën edhe më të mprehtë mesazhin, duke e çliruar nga pesha e tepërt emocionale. Vetëm një kontratë e hershme e autorit me lexuesin e tij, të lidhur heshturazi si besim i ndërsjellë, ka shpëtuar autorin nga keqkuptimi i diskursit të tërthortë ironik, si gjuhë e drejtpërdrejtë e fatale. Lexuesi e ka lexuar drejt ironinë e autorit në vorbullën e një goditjeje të zhurmshe e të përditshme të daulleve nacionaliste që kishin dominuar gjithë sferat e jetës shoqërore.

Gjergj Fishta nuk ka arritur të ruajë helmimin e gjuhës dhe nën peshën e madhe të ekzaltimit nga ngritja e flamurit rrëshqet në përdorim leksiku të palejueshëm për shkrimtarin në çfarëdo rrethane që të ndodhet:

“E der m’qiehell ushto brohrija
Kah gerthet fusha e malcija:
Per jetë t’jetës rroftë Shqypnija!
Edhe kshtu, mbas sa mjerimit
Mbas sa gjakut e shemtimit,
E p’r inat t’shkjevet t’Ballkanit
Per gazep t’atij Sulltanit:
Si premtue kisht’ perendija:
Prap zojë m’vedi duel Shqypnija.” (Fishta, *Lahuta e Malcis* f. 5)

Shkrimtari Sheimus Hini thoshte se asnjë situatë nuk e justifikon shkrimtarin të helmojë gjuhën.

c. Ironia e keqkuptuar fatalisht – konservimi i tragjedive

Në fshatin e vogël Ahmiqi gjatë luftës së përgjakshme në Bosnjë e Hercegovinë, forcat luftarake kroate kanë bërë një nga masakrat më të rënda ndaj civilëve boshnjakë. Poeti kroat Predrag Lluçiq (Predrag Lucić) shkroi një poezi satirike të titulluar *Iqi miqi*

Ahmiqi (*Ići mići Ahmići*) ku tematizon në mënyrë satirike masakrën e Ahmiqit dhe e ka botuar në kuadër të librit të tij me poezi *Hëna mbi Split*. Promovimi i këtij libri në Mostar dhe këndimi i kësaj poezie nga autori me rastin e promovimit është shndërruar në një skandal të paparë mediatik. Shoqata e qytetarëve e viktimave të luftës 92-95 reagoi me një gjuhë të ashpër, duke e kualifikuar poetin Lluciq si himnizues të krimeve kroate mbi boshnjakët.

Qëndrim i prerë i të indinjuarve se krimi nuk mund të jetë objekt satire, u mbajti edhe nga kritikë letrarë, për të cilët ky ton i poetit i përngjante më shumë himnizimit të kimit. “Na ka prekur së tepërmi poezia satirike e Predrag Lluciqit” reagues në mënyrë kategorike ata, të cilët nuk mund ta pranojnë ndryshe leximin e kësaj poezie. Situatën nuk e lehtësoi as biografia e autorit, ku thuhet se Lluciqi ishte themelues i një gazete antinacionaliste dhe antiluftë *Herald Tribune* që, me artikujt e tij kishte goditur ashpër dhe me shumë guxim elitën politike kroate dhe angazhimin e saj në luftën e Bosnjës. Por si është e mundur që një tekst i një tipi kaq të lartë komunikimi sa poezia nuk komunikon as me lexuesin estetik, siç janë disa kritikë letrarë, sulmues të ashpër të poetit? Përse nuk mund ta durojnë një ton ironik, kur autori bën objekt satire bërësit e masakrës për të mbrojtur të tjerët?

Predrag Lluciq me poezinë satirike *Iqi miqi Ahmiqi* ka dalë nga skema e njohur që është bërë një paradigmë e pashmangshme e shkrimtarëve patriotë të Ballkanit, të cilët, rreshtohen prej dy dekadash në mbrojtjen e lirisë vetëm të palës që së vet, duke hedhur plafin e zi mbi krimet e të vetëve, për të fshehur njollat e zeza në fytyrën përherë të shndritshme të pjesëtarëve të komunitetit të tij. Këtu qëndron ngatërresa e leximit që bëjnë anëtarët e shoqatës së viktimave. *Iqi miqi Ahmiqi* është një ironi e hollë dhe therëse, demaskuese e gjithë një elite politike që fshihet pas sloganeve të paqes e të drejtësisë, të solidaritetit e të pafajësisë, kurse në thelb, me veprimet që bën, posa i jepet rasti i parë, nuk dallon nga të tjerët. Nuk ka ngjarje që s’mund të bëhet objekt satire, sado e dhimbshme që të jetë ajo, por ka një mesazh që drejton autori, ka një mesazh që jep vetë teksti dhe ka një tjetër mesazh që merr lexuesi. Një mesazh kaq shumë i ndryshëm që ka marrë lexuesi nga ai që ka drejtuar autori dhe nga ai që ka rrezatuar vetë teksti, në rastin e poezisë së poetit kroat, flet për peshën e madhe të presionit emocional nën të cilin merr mesazhin nga një tekst letrar një komunitet i dhunuar rëndë, i traumatizuar, i thyer e i mashtruar.

Korpusin e tragjeditive që historia ka vënë ndërmjet shqiptarëve e serbëve ende s’ka arritur ta bëjë objekt satire asnjë shkrimtar serb apo shqiptar, në formën që bën Predrag Lluqi me tragjedinë e Ahmiqit. Ky është një korpus i ngrirë, i konservuar, i paprekshëm dhe tejet serioz. Një fushë e minuar që mund të shpërthejë në çdo cast. Si fushë e minuar, është brum i përhershëm i shkrimtarëve të sprovuar në ndezjen e emocioneve patetike nacionale.

d. Mirko Kovač - Elita më e keqe se turma

Në librin e tij *Elita më e keqe se turma* (Kovač, 2009), shkrimtari Mirko Kovac ka bërë studimin më të thellë në lidhje me angazhimin e shkrimtarit në kohët e rënda të luftrave në Jugosllavi. Luftrat e përgjakshme nga viti 1992 deri në vitin 1999 janë përgatitur si asnjëherë më parë nga elita intelektuale, akademike, nga shkrimtarët dhe klerikët nacionalistë. Statusin e fituar më heret si ndërgjegje e kombit apo si udhëheqës shpirtëror të popullit, shkrimtarët që kishin nisur ta quanin veten baballarë të kombit, kanë krijuar një model të veçantë gjuhe me të cilën në njërin anë glorifikohet historia nacionale dhe në anën tjetër fajësohen të gjithë të tjerët për sjelljen e tragjedive që kanë goditur popullin e zgjedhur. E vendosur në kontekst lufte, e të konflikteve të përgjakshme, kjo gjuhë ndizte masat për të shkuar verbërisht në katastrofa njerëzore. Por më të tërbuara se këto masa, ishin elitat intelektuale, të cilat në masë të madhe përbëheshin nga shkrimtarët e mbështjellë me fuqi e me pushtet. Shkrimtarët e fuqishëm, të mbështetur nga një makineri e fuqishme shtetërore, krijuan një gjuhë të veçantë urrejtjeje për të gjithë të tjerët dhe këtë e bënë në mënyrë sistematike në formën e një propagande të hapur. Në këtë armatë shkrimtarësh, akademikësh, regjisorësh e rrokerësh, jo gjithmonë rreshtoheshin shkrimtarët mediokër. Emir Kusturica, regjizori i njohur serb nga Bosna paralajmëroi filmin e ri me temën e Kosovës, bazuar në romanin me titull *Srpsko srce Johanovo*, të autorit Veselin Xheletoviq (Veselin Dželetović). Romani është shkruar pas suksesit që pati poema narrative me të njëjtin subjekt në stilin e këngëve me lahutë dhe pas kërkesës që bënë lexuesit për ta kthyer në një narrativë edhe më tragjike. Romani pati katër botime me tirazh të madh, kurse në promovimet që iu bënë nëpër shumë qytete të Serbisë, simpatizantët mbushën sallat, madje një pjesë e madhe mbetën jashtë. Gjermani i pasur Johan, bën transplant zemre dhe i japin zemrën e serbit nga Kosova Jovan. Ëndrrat e çojnë gjermanin në vendlindjen e serbit të trafikuar nga shqiptarët dhe pasi mëson gjithë historinë e zemrës së tij, vendos të ndërrojë fe dhe bëhet ortodoks me emër Jovan. Konstrukte të tilla narrative të nisura që prej 30 vitesh, kanë ruajtur të njëjtën strukturë pllakateske gjuhësore, të njëjtën frymë propagandistike për të vënë narrativën letrare si iluzion të së vërtetës dhe për ta përdorur për konsum politik, të njëjtën frymë nacionaliste që e moderojnë, për çudi, nëpër makinerinë e fuqishme mediatike, të njëjtët gazetarë të politpropit.

Armiq dhe njerëz

Për më shumë se një shekull serbët dhe shqiptarët, dy popuj fqinj në Ballkan, kanë ngritur në mes figurën e palëkundur të armikut. Atë që kanë nxjerrë betejat e përgjakshme në terren, e kanë përjetësuar shkrimtarët nacionalistë dhe e kanë konservuar shkrimtarët baballarë të kombit. Para se të farkëtohej, në terren këtë figurë e kanë ideuar shkrimtarët militantë mediokër, por fatkeqësisht, edhe shkrimtarë me nam të madh, emri i të cilëve mbërrin përmasat e shtrirjes së gjerë në gjithë

globin si përfaqësues të denjë të kulturës ballkanike. Shkrimtarë e dijetarë të paktë si Radovan Zogoviq, Dimitrije Tucoviq, Mirko Kovaç, Ali Podrimja, Jevrem Brkoviç etj. kanë provuar të shkrepin shkëndija humanizmi në një arenë ujçerish. Por fuqia e shkrimtarëve që kanë konzervuar për një kohë kaq të gjatë figurën e armikut ka qenë marramendëse. Askush s’ka thirrur për pendim dhe falje. Prandaj kjo figurë u konservua për një shekull të tërë dhe vazhdon të kultivohet edhe sot e gjithë ditën.

Për të dhënë fuqinë paqësuese që sjell pendesa dhe ulja e kokës përpara krimit, po japim një fragment nga shkrimtari rus Jevtushenko:

“Më 1944, nëna ime dhe unë u kthyem në Moskë dhe ishte hera e parë në jetën time që shihja armiq. Ishin, nëse s’më kujtohet keq, njëzetepesë mijë robër gjermanë që duhej të përshkonin rrugët e qytetit të rreshtuar në një kolonë të gjatë. Trotualet ishin plot me njerëz që mbaheshin mbrapa nga ushtarët dhe policët. Një turmë e pamasë. Të gjitha – gra, gra ruse me duar burri, të shformuara nga lodhja, me buzë që nuk e kishin njohur të kuqtë, me shpatulla të dobëta kockore. Secilës prej tyre, me siguri, gjermanët u kishin çuar larg ose babanë, ose burrin, ose vëllanë, ose djalin. Ndër të tjera, kishte urrejtje në sytë e atyre grave që po rrinin duke pritur kolonën e robërve dhe shihnin me akth andej nga kreu i rrugës. Më në fund u dukën. Përpara ishin gjeneralët. Marshonin me fytyra fodulle, me nofulla të shtrënguara. Cepat e buzëve të tyre ishin të thata: kishin ngjyrën e përçmimit. Në këtë mënyrë, ata, donin të ridëshmonin epërsinë e tyre ndaj popullit që i kishte mundur. Gjatë kalimit të tyre duart punëtore të grave u shtrënguan e u bënë grusht. “U qelbkan era kolonjë këta maskarenj!” – klithi një zë dhe ushtarëve dhe policëve u duhej të përdornin të tërë fuqinë e tyre për të mbajtur mbrapa gratë që donin të çanin pengesat. Papritmas ndodhi një gjë pothuaj e jashtëzakonshme. Mbrapa gjeneralëve, ecnin ushtarët: Të dobët, të zhyer, të parruar, kokën të lidhur me lecka të gjakosura. Disa mbështeteshin mbi paterica, të tjerët – mbi shpatullat e shokëve të paplagosur. Kokën e mbanin poshtë. Askush nuk klithi më. Një heshtje vdekjeje mbuloi rrugën. Dëgjohej vetëm zhurma e shuajve të këpucëve dhe e patericave përmbi kalldrëm. “Lërmëni të kaloj!” – tha atëherë një grua me çizme të mëdha ruse, duke vënë dorën mbi shpatullën e një polici. Ishte kaq i vendosur zëri i kërkesës së saj sa që polici e la të kalonte sikur të paskësh marrë një urdhër të prerë. Duke u afruar te kolona e robërve, gruaja nxori nga xhybja e saj një copë bukë të zeze dhe ia dha njërit prej tyre. Gra të tjera ndoqën shembullin e saj dhe u hidhnin bukë, cigare dhe gjëra të tjera ushtarëve gjermanë. Dhe ata si me magji pushuan së qeni armiq. Tashmë ishin vetëm njerëz, asgjë më tepër se njerëz.”

(Yevtushenko, 1963, 27)

Dobrica Qosiq (Dobrica Ćosić), një nga baballarët e kombit, njeriu që ideoi dhe figuroi armikun për 50 vjet në marrëdhëniet shqiptaro serbe, në intervistën e fundit para se të vdiste, pa fije pendese, u mjaftua që brezave që vijnë t'u thotë:

“Për mua çështja e Kosovës tashmë u zgjidh. Domethënë, ajo nuk ekziston më si krahinë jugore serbe. Brezit tuaj i këshilloj të mos humbasë më forcë për çështjen kosovare, sepse historia e zgjithi atë për ju” (Ćosić, 2014). Kështu deklaroi presidenti i fundit i Republikës Federale të Jugosllavisë, duke shprehur keqardhjen që idenë e tij për ndarjen e Kosovës nuk ia pranuan në vitet 60-të të shekullit XX.

Literatura:

ANDRIĆ I. (1939) *Referat g. Andrića 30.1.1939*, i disponueshëm në http://www.27mart.com/images/File/Andric_lat_pdf (e parë më 1.03.2015).

ĆOSIĆ D. (2014) *Intervju*. Nedeljnik, 24.04.2014. Beograd.

ČUBRILLOVIĆ V. (1937) *Isterivanje Arnauta*, e disponueshme në <http://archive.is/dgaUm/> (e parë më 10.03.2015).

FISHTA, Gj. (2010) *Lahuta e Malcis*. Tiranë: 2010.

GJORGJEVIQ, V. (2012) *Shqiptarët dhe fuqit e medha*. Tiranë, Konica.

KOVAČ, M. (2009) *Elita gora od rulje*. Zagreb: Fraktura.

PODRIMJA, A. (2013) *Vepra 1-9*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

SCHMITT, O. (2012) *Kosova – histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha.


STRANJAKOVIĆ, D (1939) *Kako je postao Garašaninovo “Načertanije”*, Beograd: Spomenik SKA, XCI, fq. 76-102.

TODOROVA, M. (1997) *Imagining the Balkans*. New York: Oxford University Press.

Tucovic, D. (1980) *Sabrana dela*. Beograd

YEVTUSHENKO, A.Y (1963) *A Precious Autobiography*. New York: Dutton & Co.

ZOGOVIĆ, R. ((2009) *Ardhësit – kangët e Ali Binakut – Dosljaci – pjesme Ali Binaka – Newcomers – songs of Ali Binaku*. Prishtinë: Ars Albanica.



Basri Capriqi

Faculty of Philology

University of Prishtina

Enemies and Men

Abstract:

In the first part, this article embraces the idea of a common Balkan identity that has roots in Antiquity and of linguistic and cultural Balkan unity following from the Ancient Greek culture. It then follows the demise of this Balkan identity during the rise of nationalism in the nineteenth-century, and advocates that it is the time to leave the conflict in the past and to pacify and reunite the Balkans in the European Union. The second part of the article discusses negative influence of writers on promoting the conflicts in the Balkans, to emphasize several authors and literary works that by its pacifism and humanism stand out from the main current: *The Immigrants – the Songs of Ali Binak* by Radovan Zogović, Ali Podrimja's *Happy Ending*, Predrag Luci's *Ići Mići Ahmići* and *The Elite Worse Than the Crowd* by Mirko Kovač.

Key words:

Balkan, enemies, Balkan identity, writers and conflict

